

Kërkese për Vende Vakante

Datë: 20/05/2021

Rreth Fushë Krujë Cement Factory: Ne jemi një Kompani që prodhojmë dhe shesim çimento. Adresa jonë është në Fshatin Zallë, Fushë Krujë. Transporti i punonjësve organizohet nga ana e Kompanisë.

Pozicioni i kërkuar: Inxhinier Mekanik

Përshkrim i Përgjithshëm: Inxhinieri Mekanik ka objektivi primar të mbajë pajisjen në gatishmëri dhe vlefshmëri gjatë të gjithë kohës dhe të paraqesë dhe të zhvillojë proceset për mirembajtjen dhe praktikatat e inxhinierike.

Detyra për t'u përbushur:

- Të shërbejë si një rol model në fushat e shëndetit dhe sigurisë në punë, mbrojtjes së mjedisit, lidershipit, puna në grup, fokusi ndaj klientëve dhe zhvillimit të vazhdueshëm për të siguruar përputhje me vizionin e kompanisë dhe faktorët kritikë të suksesit.
- Të asistojë në zhvillimin e proceseve të rekomandimit dhe menaxhimit të programeve të besueshmërisë së makinerive (Analiza rrenjësore e defekteve/Kohën Mesatare Midis Defektve)
- Të kryejë studime për të siguruar besueshmërinë e përgjithshme dhe kapacitetin e makinerive nepërmjet standarteve të cilësisë dhe përbushjes së kërkesave të tjera.
- Të punojë më supervizorin e mirëmbajtjes për të siguruar performancën dhe efikasitetin optimal të aktiviteteve të mirëmbajtjes.
- Të planifikojë dhe ekzekutojë Projekte të përmirësimit të Besueshmërisë së Makinerive me qëllimin për të mbështetur Prodhimin dhe që të sigurojnë performancën në rritje të fabrikës.
- Të rishikojë specifikimet inxhinierike/vizatimet dhe të propozojë modifikime në dizejnimin për të përmirësuar besueshmërinë e makinerive brenda kostos së planifikuar dhe sipas kërkesave të tjera.
- Të monitorojë performancën e pajisjeve dhe të vlerësojë historikun e pajisjeve dhe të trendeve të defekteve për të përcaktuar burimet e komponentëve të dobët të performancës.
- Të vlerësojë llojet e defekteve dhe të shfrytëzojë eksperiencën inxhinierike dhe trajnimet për të zhvilluar zgjidhje për eliminimin/zvogëlimin e defekteve potenciale.
- Të sigurojë ose mbajë eksperimentat teknike mbi optimizimin e pajisjeve për të ndihmuar prodhimin, procesin dhe mirëmbajtjen e departamenteve
- Të asistojë në implementimin e projekteve me sa më pak nevojë për mbikqyrje.
- Të performojë me një rol kontribues në krijimin e listës për pjesë këmbimi

Kualifikimi i kërkuar: Diplomë në Inxhinieri Mekanike

Aftësitë dhe njohuritë e kërkuara:

- Të jetë i familjarizuar me softëtarët e automatizuar si Autocad dhe SolidWorks
- Të ketë aftësi për të kryer disa detyra njëkohësisht duke ruajtur aftësitë organizative.
- Të ketë aftësi të mirë lidershipi
- Preferohet të ketë njohuri në menaxhimin e projekteve dhe kontrollin e kostove
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze

Kandidatët të dërgojnë: CV në formatin Europass dhe Letër motivimi me shkrim dore dhe të firmosur nga kandidatët në adresën e emailit: elma.zeneli@fkcementfactory.com